UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/344
Datë: 22/6/2016

Senati i Universitetit të Prishtinës bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 31, paragrafit 1, pikës 4 të Rregullores së punës së Senatit nr.1/1001 të datës 06.06.2014, miraton këtë:

REKOMANDIM

I. Me qëllim të vlerësimit objektiv dhe transparent si dhe në përputhje të plotë me kriteret e Statutit të UP-së, në lidhje me publikimet në revista ndërkombëtare sipas pikës 1.2.1, paragrafit 1, të nenit 175; të pikës 1.2, paragrafit 1, të nenit 176; dhe pikës 1.2, paragrafit 1, të nenit 177 të Statutit të UP-së si dhe Rregullores për Studime të Doktoratës, Senati i UP-s rekomandon si vijon:
   a) Si autor kryesor i punimit të konsiderohet autori i parë, përveç nëse në punim është e specifikuar ndryshe;
   b) Si autor korrespondent të konsiderohet autori i cili është i identifikuar si i tillë në punimin e botuar;
   c) Në rastet kur autori korrespondent nuk është i identifikuar, si autor korrespondent të konsiderohet ai i cili identifikohet si i tillë nga autori i kryesor i punimit;
   d) Në rastet kur në momentin e vlerësimit të aplikacionit, nuk mund të sigurohet konfirmimi i autorit kryesor në lidhje me autorin korrespondent, si i tillë të konsiderohet autori i parë nga UP-ja në listën e autorëve të punimit;
   e) Një punim në frymën e këtij rekomandimi, të shfrytëzohet për zgjedhje nga jo më shumë se dy kandidatë të UP-së.

II. Si punime shkencore gjatë vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs të merren në konsiderim punimet e publikuara në revistat të cilat janë të indeksuara në njërën prej bazave akademike si në vijim:

   1. Web of Science (Thomson Reuters) (https://webofknowledge.com)
   2. Scopus (Elsevier) (https://www.scopus.com)
   3. WorldWideScience (http://www.worldwidescience.org)
   4. Microsoft Academic Search (http://academic.research.microsoft.com)
   5. ERIC: Educational Resource Information Center (http://www.eric.ed.gov)
   6. Directory of Open Access Journals (http://www.doaj.org)

7. WorldCat (http://www.worldcat.org)
8. SSRN: Social Science Research Network (http://www.ssrn.com)
9. Central and Eastern European Online Library (https://www.ceeol.com)
10. Scimago Journal & Country Rank (http://www.scimagojr.com)
11. EBSCOhost (https://www.ebscohost.com/academic)
12. H-Soz-Kult (http://www.hsozkult.de)
13. PubMed (http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed)
14. ProQuest (http://www.proquest.com/libraries/academic/databases)
15. Wiley Online Library (http://onlinelibrary.wiley.com)
16. MathSciNet (http://www.ams.org/mrlookup)
17. zbMATH (https://zbmath.org)
18. ULAKBIM – National Academic Network and Information Center (http://cabim.ulakbim.gov.tr/tr-dizin/tr-dizinde-dizinlenen-dergi-listesi)[1]
19. ASOS - Academia Social Science Index (http://asosindex.com)[1]
20. LexisNexis (http://www.lexisnexis.com/en-us/home.page)
21. WestLaw (http://www.westlaw.com)
22. Low Library (http://lawlib.wlu.edu/LJ)
23. ERIH (European Reference Index for the Humanities) (http://www.esf.org/)
24. ERIH PLUS (https://dbh.nsd.uib.no/publiseringskanaler/erihplus)
25. Index to Foreign Legal Periodicals (https://www.law.berkeley.edu/library/iflp/periodicals.html)
26. IEEE Xplore Digital Library (http://ieeexplore.ieee.org)
27. ACM Digital Library (http://dl.acm.org)
28. dblp: Computer Science Bibliography (http://dblp.uni-trier.de)
29. BASE (Bielefeld Academic Search Engine) (https://www.base-search.net)
30. University Library of Regensburg (http://www.uni-regensburg.de/library)
31. DNB, Katalog der Deutschen Nationalbibliothek (https://portal.dnb.de)
32. Road Directory of Open Access Scholarly Resources (http://www.issn.org)
33. Hrvatska znanstvena bibliografija (https://bib.irb.hr)
34. Virtual Library of Slovenia (http://www.cobiss.si/cobiss_eng.html)
35. CrossRef (http://www.crossref.org)
36. Google Scholar (https://scholar.google.com)

III. Punimet e botuara në Kosovë dhe revista të rajonit, të konsiderohen si punime në revista ndërkombëtare vetëm nëse revistat e tilla janë të indeksuara në bazat akademike Web of Science dhe Scopus.

IV. Përjashtimisht, për arsye të natyrës kombëtare të kërkimeve shkencore, për personelin akademik nga fusha e albanologjisë, historisë shqiptare dhe etnologjisë si dhe rekomandohet të merren në konsiderim edhe punimet e publikuara në revistat shkencore rajonale si në vijim:

[1] Vlen vetëm për personelin akademik nga fusha e Gjuhës dhe Letërsisë Turke

a) Fusha e albanologjisë:

- Studime, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë
- Studia Albanica, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë
- Seminari Ndërkombëtar i Gjuhës, i Letërsisë dhe i Kulturës Shqiptare, Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës (http://filologjia.uni-pr.edu/Seminari.aspx).

b) Fusha e historisë shqiptare dhe etnologjisë:

- Studime historike, Instituti i historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë
- Studime Albanologjike, Fakulteti i Historisë & Filologjisë, Universiteti i Tiranës

V. Punimet e kandidatëve të indeksuara në bazat akademike (3)-(36), mund të merren në konsiderim nëse plotësojnë edhe kushtet vijuese:

- Të mos jenë punime konferencash
- Të mos jenë në lista të revistave dhe botuesve të dyshimtë

VI. Ky rekomandim të vlejë, për kandidatët të cilët kanë konkurruar ose konkurrojnë në konkursin për zgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik, deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" • UNIVERSITY OF PRISHTINA • 1970

Prof. Dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së